

REVISTA E SHKENCAVE MJEKËSORE E KOSOVËS JOURNAL OF MEDICAL SCIENCES OF KOSOVA

Revista e Shkencave Mjekësore e Kosovës (Journal of Medical Sciences of Kosova – JMSK) është publikim official i Kolegjit Iliria – Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Prishtinë, i cili botohet dy herë në vit.

Në fillim, Ju falenderohemi për vendimin tuaj për të publikuar punimin, pikërisht, në revistën tonë.

Për nevoja të autorëve, ne kemi përgatitur Udhëzuesin për autorët, me kërkesat unike për dorëzimin e manuskripteve për botim.

I). KATEGORITË E PUNIMEVE

JMSK boton: (1) punime origjinale (Original Articles), (2) punime reviale (shqyrtime sistematike) (Review Articles), (3) prezentime rasti (Case Reports), (4) raporte të shkurtëra (Brief Reports), (5) komente (Comments), (6) letër editorit (Letter of the Editor), (7) letër përgjigje (Letter in Replay) dhe (8) letër hulumtimi (Research Letter).

(1) PUNIM ORIGINAL (RESEARCH ARTICLE)

Punimet origjinale zakonisht përfshijnë: eksperimente me metodën e rastit – Hulumtimet klinike (randomised trials), studime intervenimi, studimet kohorte (Cohort study), Studimet me raste-kontrollë (Case-control study), vlerësime epidemiologjike, studime tjera observuese, hulumtime me shkallë të lartë të përgjigjeve (high response rate), analiza të kost-efektivitetit dhe analiza të vendimeve, si dhe studimet e screeningut dhe te testeve diagnostike.

Përmbajtja e punimeve origjinale: Titulli, Abstrakti, Fjalët bosht, Hyrja, Materiali dhe metodat, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimet dhe Referencat (Literatura).

Mund të përmbajë edhe: Falenderimet (mirënjohjet), Shtojcën, Tabela, Figura, etj.

(2) PUNIM REVIAL (SHQYRTIM SISTEMATIK) (REVIEW ARTICLE)

Shqyrtim përmbajtësor kritik nga literatura shkencore dhe përmbledhja e saj në temën e cila përgjithësisht është subjekt i së paku 40 punimeve shkencore të publikuara.

Përmbajnë: Titullin, Planin (Outline), Abstraktin, Fjalët bosht, Hyrjen, Shqyrtimin nga literatura, Përmbledhjen (Summary) dhe Referencat (Literaturën).

Mund të përmbajë edhe: Falenderimet (mirënjohjet), Shtojcën, Tabela, Figura, etj.

(3) PREZENTIM RASTI (CASE REPORT)

Raport i ndonjë rasti klinik të rrallë, ose përmirësimi i menaxhimit dhe trajtimit të sëmundjes me ndonjë metodë të re. Teksti duhet pasur më së shumti 3500 fjalë (duke përfshirë referencat, ilustrimet dhe abstraktin).

Përmbajnë: Titullin, Abstraktin, Fjalët bosht, Hyrjen, Përmbledhja e rastit (prezentimi i rastit), Diskutimin dhe Referencat (Literaturën).

Mund të përmbajë edhe: Falenderimet (mirënjohjet), Shtojcën, Tabela, Figura, etj.

(4) RAPORT I SHKURTËR (BRIEF REPORT)

Këto dorëshkrime janë raporte të shkurtra të studimeve origjinale ose janë vlerësime ose raportet e para të serive të rasteve klinike. Vërejtje: Kërkohe abstrakti i strukturuar. Teksti duhet të ketë deri 1800 fjalë (pa përfshirë abstraktin, tabelat, figurat dhe referencat) dhe jo më shumë se 3 tabela dhe/ose figura në total.

Përmbajnë: Titullin, Abstraktin, Fjalët bosht, Hyrjen, Metodën, Rezultatet (outcomes) dhe Diskutimin.

(5) KOMENTE (COMMENT)

Këto shkrime mund të adresojnë në praktikë ndonjë temë me rëndësi në mjekësi, shëndet publik, hulumtime, etikë, politikë shëndetësore, legjislacion shëndetësor, dhe në përgjithësi nuk janë të ndërlidhura me ndonjë artikull specifik. Komenti duhet të jetë mirë i fokusuar, akademik, i prezantuar mirë dhe nuk duhet pasur më shumë se 2 autorë. Teksti duhet pasur më së shumti 2500 fjalë dhe jo më shumë se 10 referenca. Abstrakti nuk është i domosdoshëm.

(6) LETËR EDITORIT (LETTER TO THE EDITOR)

Letra e cila ndërlidhet me ndonjë artikull të botuar në revistë mund të publikohet nëse letra pranohet brenda 4 javësh nga data e publikimit të artikullit. Letra mund të ketë më së shumti 3 autorë, 300 fjalë (numri i fjalëve të shënohet në letër), hapësira e dyfishtë midis rreshtave, dhe 5 referenca, përndryshe nuk merren në konsiderim. Teksti i letrës duhet pasur emrat, titujt akademik, institucionet primare për të gjithë autorët dhe adresën e postës elektronike për autorin i cili do merret me korrespondencë. Letrat duhet të kenë një ton respektimi, duke iu shmangur gjuhës konfrontuese dhe të zjarrtë, me kufizime të kritikizmit ndaj metodave shkencore ose ndaj rëndësisë së punimit. Redaktori vendos për botim të letrës, në pajtim me kërkesat për stil dhe përmbajtje.

(7) LETËR PËRGJIGJE (REPLIKË ME AUTORIN) (LETTER IN REPLAY)

Përgjigjet e autorëve duhet pasur më së shumti 500 fjalë dhe 5 referenca, me jo më shumë se 3 autorë të Letër përgjegjës.

(8) LETËR HULUMTIMI (RESEARCH LETTER)

Kur raportohet hulumtimi origjinal pranoen dorëshkrimet me maksimum 600 fjalë (numri i fjalëve të shënohet në letër), hapësira e dyfishtë midis rreshtave, 1 tabelë ose figurë dhe 6 referenca; më së shumti 5 autorë, ndërsa të tjerët mund të shënohen në Falënderime, me lejen e tyre dhe të dhëna për titujt, institucionin, kontributin për hulumtim dhe a kanë marrë kompensim për rolin e tyre. Letrat nuk duhet të dyfishojnë materialin tashmë të botuar ose në pritje për botim. Letra Studiuuese i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm para publikimit.

Përmbajnë: Redaktorit (si hyrje), Metodatat, Rezultatet dhe Komenti. Nuk duhet pasur abstrakt.

II). FORMATI I PUBLIKIMIT**A) Udhëzuesi për shkruarjen e punimeve dhe Stili editorial****1) Udhëzuesi për shkruarjen e punimeve**

Kërkesat e JMSK për botimin e artikujve janë të shumta dhe gjithëpërfshirëse, andaj JMSK ka specifikuar kërkesat për llojet e ndryshme të artikujve. Udhëzimet mund t'i gjeni në seksionin: "Udhëzimet për autorë".

2) Stili editorial

Stili editorial i kërkuar nga JMSK është në përputhje me "Uniform Requirements for Manuscripts Submitted to Biomedical Journals", përgatitur nga International Committee of Medical Journal Editors⁽¹⁾.

Teksti i punimeve origjinale, ekperimentale dhe observuese, zakonisht strukturohet sipas "IMRAD" strukturës, në këto seksione: Hyrja (**I**ntroduction), Metodatat (**M**ethods), Rezultatet (**R**esults) dhe Diskutimi (**a**nd **D**iscussion). Llojet tjera të artikujve, si: prezentim rasti, meta-analiza, editorialët, etj. duhet të formatohen në mënyra të ndryshme.

Punimet botohen në gjuhën angleze, me Rezyume në gjuhën shqipe, kurse në formën elektronike punimi publikohet edhe në gjuhën shqipe, nëse autori e ka të përgatitur punimin edhe në gjuhën shqipe. Punimi shtypet në rreshta të rregulltë, me rrallorin një (1) të kompjuterit, në fontin Times

⁽¹⁾ International Committee of Medical Journal Editors. Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals. JAMA. 1997 Mar 19;277(11):927-34.

New Roman, madhësinë e fontit 11, në format A4, me margjinë 3 cm përreth. Punimi duhet të dorëzohet i lekturuar.

B) Shqyrtimi Editorial dhe procesimi

1) VLERËSIMI I JASHTËM (PEER-REVIEW EVALUATION)

Anëtarët e Bordit Editorial të JMSK e bëjnë evaluimin e të gjitha dorëshkrimeve (manuskripteve), me disa përjashtime. Përjashtimet përfshijnë: ligjëratat mbi historinë dhe filozofinë e literatureës mjekësore, editorialët, seancat e takimeve vjetore të Shoqatës së Bibliotekave Mjekësore, komentet dhe opinionet, letër editorit, kritikën e librave dhe të burimeve elektronike.

Revista (JMSK) shfrytëzon procesin e vlerësimit të jashtëm (peer-review) dyfish të fshehtë, në të cilin anëtarët e bordit editorial nuk e njohin identitetin e autorit, sikurse që autorit nuk i tregohet identiteti i vlerësuesit të manuskriptit.

Manuskripti në fillim vlerësohet a i përmbushë kërkesat minimale për pranim, nga tre anëtarë të bordit editorial ose nga ekspertët e lëmit, të zgjedhur nga editori. Manuskripti fillimisht evaluohet sipas kriterëve të specifikuar në Listën verifikuese të manuskriptit: struktura e punimit sipas seksioneve të saj, varësisht në kategorinë e punimit, a është materiali origjinal dhe i kohës, a është shkrimi i qartë, i nivelit të duhur akademik, a janë metodat studimore të duhura, a janë të dhënat valide, konkluzionet a janë të bazuara dhe të mbështetura nga të dhënat, a ka relevancë shkencore punimi, a ka tema të zgjedhur rëndësi të përgjithshme mjekësore dhe përshtatshmëria e literatureës së shfrytëzuar.

Manuskriptet që nuk i përmbushin kriteret minimale për pranim refuzohen menjëherë. Manuskriptet tjerë dërgohen për vlerësim të jashtëm (peer review). Vlerësimi i jashtëm i punimeve bëhet sipas formës unike për vlerësim, e cila përmban: komentet e përgjithshme, komentet për autorët (me sugjerimet për të gjitha pjesët e punimit veç e veç), rekomandimet çka të ndryshojë në punim, në mënyrë që të botohet dhe komentin përfundimtar.

Autorët do të njoftohen me email për pranimin e punimit, refuzimin e punimit, apo nevojën për rishikim të dorëshkrimit të tyre sipas rekomandimeve.

2) PARAQITJA E DORËSHKRIMIT

Punimet duhet të dorëzohen përmes postës elektronike, në formatin elektronik në Word dhe WordPerfect, jo PDF. Dorëzimi i manuskriptit në formën elektronike mundëson komunikimin më efikas ndërmjet autorit/ëve dhe editorit, si dhe mundëson dorëzimin e materialit shtesë për vlerësim të jashtëm (peer review), nëse ka nevojë për këtë.

Punimet mund të dorëzohen në adresën:

blerim.krasniqi@gmail.com

Institute for Scientific Research
Department of Medical Sciences,
Iliria College
Lagja Veternik, 10000 Prishtina, Republic Of Kosova
phone: +381-38-544754
fax: +381-38-544756
www.rezonanca.com

Në vijim ju kemi paraqitur një përmbledhje të kërkesave për të gjitha llojet e dorëshkrimeve (manuskripteve) të JMSK:

1) Letra Hyrëse (Cover letter). Letra hyrëse përmban këto informata: titullin e punimit, emrat e autorëve, përkatësia institucionale (institucionet ku ata punojnë), përgjegjësia autoriale dhe kontributet për t'u kualifikuar si autor, shfajësimet (nëse ka ndonjë), informatat për kontakt me autorët korrespondues (emri, e-mail adresa, telefoni and numri i faksit), kategoria e punimit, a është prezantuar në ndonjë takim shkencor a profesional (nëse po, në cilin takim dhe cilën datë), numri i fjalëve në abstrakt, numri i fjalëve në punim (vetëm për tekst, duke përjashtuar abstraktin, mirënjohjet, legjendat e figurave dhe referencat), numrin e figurave, tabelave dhe grafikoneve. Formën e Letrës hyrëse mund ta shkarkoni nga webfaqja e revistës, në adresën: www.rezonanca.com

2) Deklarata për përgjegjësinë autoriale, kriteret dhe kontributet,

3) Deklarata financiare dhe mbështetja me fonde,

4) Deklarata e mirënjohjeve dhe

5) Pajtimi për transferimin e të drejtave autoriale/pajtimi për botim

Të gjitha mund të dërgohen me fax ose email (pas skenimit).

UDHËZIMET PËR AUTORËT PËR MËNYRËN E SHKRUARJES SË PUNIMEVE

STRUKTURA E PUNIMIT ORIGINAL

TEKSTI I PUNIMIT

Punimet origjinale kërkimore-shkencore, profesionale dhe revyale mund të kenë deri 12 faqe (me të gjitha shtesat), përshkrimi dhe raporti i rasteve interesante deri në 6 faqe, kurse çdo shkrim tjetër (p.sh. raporti nga tubimet shkencore dhe profesionale, recensione librash, njohuri të reja nga mjekësia ose letër redaksisë) 1-2 faqe.

Titulli duhet të jetë konciz dhe informativ. Ai duhet të jetë i saktë (të përshkruajë me përpikëri përmbajtjen e punimit me sa më pak fjalë dhe shërben si bazë për indeksim, abstrakte e regjistrë të literaturës), mundësisht sa më i shkurtër (kursen kohën dhe hapësirën), specifik, i plotë dhe i qartë. **Shkurtesat** nuk përdoren në titull ose abstrakt.

Emrat e autorëve. Nën titull shënohet emri dhe mbiemri i plotë i çdo autori. Nëse autorët nuk janë punonjës të të njëjtit institucion, ose në të njëjtën adresë, atëherë tek emrat e autorëve përdoren fusnotat, në formë të numrave arab të pasuar me kllapë të thjeshtë: (p.sh. Emri Mbiemri ¹⁾, Emri Mbiemri ²⁾, etj.). Fusnotat me numra arabë tregojnë **institucionet ku punojnë autorët** e caktuar dhe shënohen nën pjesën e emrave të autorëve.

Rezymea, pa shënime për autorët, shkruhet në vetën e tretë njëjës, jo më shumë se 250 fjalë (më të shumtën një faqe). Kjo përmban vështrimin e përgjithshëm të temës, qëllimin e punimit, materialin dhe metodat, rezultatet dhe përfundimet kryesore (pa të dhëna nga literatura).

Fjalët bosht - nën rezymë shënohen 2-5 *fjalë bosht* (ose fraza të shkurtëra), që janë thelbësore për klasifikimin dhe identifikimin e përmbajtjes së punimit.

Titulli dhe rezymea e punimit shkruhet edhe në gjuhën shqipe.

Teksti i punimit duhet të përmbajë *hyrjen, materialin dhe metodat, rezultatet, diskutimin dhe përfundimin*.

Hyrja duhet të jetë sa më e shkurtër dhe të paraqesë në mënyrë të qartë e të saktë thelbin e problemit dhe qëllimin e punimit. Shkruhet në kohën e tashme. Referencat që merren me këtë problem të përmenden në mënyrë telegrafike. Të dhënat nga literatura (autorët, referencat), kudo që përmenden në tekst të punimit, duhet të shënohen në kllapa, me shifra arabe, të cilat duhet t'u përgjigjen atyre në *regjistrin e literatures*.

Materiali dhe metodat e punës duhet të përmbajnë të dhënat se çka dhe si, ku dhe kur është punuar. Shkruhet në kohën e kaluar.

Përzgjedhja dhe Përshkrimi i pjesëmarrësve

Përshkruani mënyrën e përzgjedhjes së pjesëmarrësve (të sëmurët ose kafshët laboratorike, duke përfshirë edhe grupin e kontrollit) në mënyrë të qartë, duke përshkruar kriteret për përfshirjen, kriteret për përjashtimin e subjekteve si dhe përshkruani burimin e popullacionit të përfshirë në studim.

Informacione teknike

Identifikoni metodat, aparatet (jepni emrin dhe adresën e prodhuesit në kllapa), dhe procedurat me detaje të mjaftueshme për të lejuar të tjerët për të riprodhuar rezultatet. Metoda e punës përshkruhet qartë, meqë ia bën të mundur lexuesit ta kuptojë punimin. Metodat e njohura nuk përshkruhen, por përmenden nga literatura (shkruhen referencat), duke përfshirë edhe metodat statistikore (shih më poshtë); ofroni referenca dhe përshkrime të shkurtëra për metodat që janë botuar, por nuk janë të njohur sa duhet; përshkruani metodat e reja apo metodat e modifikuara në mënyrë substanciale, duke dhënë arsyetimet për përdorimin e tyre, si dhe duke vlerësuar kufizimet e tyre. Përshkruani saktësisht të gjitha barnat dhe substancat kimike të përdorura, duke përfshirë emrat gjenerikë, dozat, dhe rrugët e aplikimit.

Statistika

Përshkruani metodat statistikore me detaje të mjaftueshme për të mundësuar që, me qasje në të dhënat origjinale, të verifikohen rezultatet e raportuara. Referencat për dizajnin e studimit dhe metodat statistikore duhet të jenë pjesë e përhershme e punimit. Definoni terminet statistikore, shkurtesat dhe simbolet. Specifikoni programet kompjuterike të përdorura.

Rezultatet e punimit duhet renditur qartë dhe saktë. Shkruhen në kohën e kaluar. Rezultatet duhet të jenë të përpunuara statistikisht. Rezultatet prezentohen me një renditje logjike në tekst, tabela dhe ilustrime, duke dhënë së pari rezultatet më të rëndësishme për punimin. Mos i vendosni të gjitha shënimet e tabelave ose ilustrimeve në tekst. Materialet tjera shtesë ose plotësuese, si dhe detajet teknike, mund t'i vendosni në një shtojcë, të cilat mund të publikohen vetëm në versionin elektronik të revistës. Jepin rezultate numerike, jo vetëm si përqindje, por edhe si numra absolutë, nga të cilat janë llogaritur ato, si dhe specifikoni metodat statistikore të shfrytëzuara për të analizuar ato. Diagramet përdorni si një alternativë të tabelave me shumë të dhëna. Mos i paraqitni të dhënat në të dy format, në tablela dhe në digrame. Dukuritë dihotome mos i paraqitni në mënyrë grafike.

Diskutimi është interpretimi i rezultateve të përfuara dhe krahasimi i tyre me njohuritë e deritashme e me të dhënat nga literatura dhe shkruhet në kohën e tashme. Mos i përsëritni në detaje të dhënat ose informatat e dhëna në Hyrje ose në seksionin e Rezultateve. Preferohet që diskutimi të fillohet nga përmbledhja e shkurtër e gjetjeve kryesore, pastaj shqyrtimi i mekanizmve të mundshëm, ose shpjegimi i këtyre gjetjeve, duke krahasuar rezultatet me studimet tjera

përkatëse, konstatimin e kufizimeve të studimit dhe eksplorimin e ndikimeve të gjetjeve në hulumtimet e ardhshme dhe në praktikën klinike.

Përfundimi është në përputhje me qëllimin e punimit dhe me diskutimin. Në të autori jep mendimet, sugjerimet dhe propozimet e veta.

Një **mirënjohje** e shkurtër, kushtuar atyre që e kanë ndihmuar autorin, mund të shënohet në fund të tekstit. Individët të cilët përmenden në këtë pjesë duhet të njoftohen paraprakisht se keni shprehur dëshirën t'i përfshini në këtë rubrikë, për çka duhet të merrni lejen nga të njëjtit për këtë emërim.

Referencat (regjistri i literaturës) shkruhen në fund të punimit. Autorët (referencat), të cilët përmenden me shifra arabe në kllapa në tekstin e punimit, me font dhe madhësi të njëjtë sikurse edhe teksti tjetër, në regjistër të literaturës radhiten sikurse janë përmendur në tekst. Shënohet numri rendor arab, pastaj të gjithë autorët e referencës, përveç nëse janë më shumë se 6 autorë, kur do të shkruhen 3 autorët e parë me shkurtesën **e b.p.** (që d.t.th.: e bashkëpunëtorë). Pika nuk përdoret pas inicialeve të emrave të autorëve. Shkurtesat për revista shënohen sipas regjistrin në Index Medicus, Journal Indexed for MEDLINE, të publikuar nga NLM në Library's Web site.

Citimi i Web dokumentave duhet të përfshijë edhe datën e qasjes në këto burime.

Referencat në punimet e pranuar por ende të pabotuara duhet të shënohen "në shtyp" ("in press"), kurse autori duhet të sigurojë lejen me shkrim për citimin e këtij punimi, sikurse edhe verifikimin se punimi është pranuar për publikim.

Shembuj të stilit të shënimit të referencave

1.Revista

Yazigi R.	autori
Breast cancer metastazing to the uterine cervix.	titulli
Cancer	emri i revistës
1988:	viti
61:	vëllimi
(12):	numri
558-60.	faqet

1. Yazigi R. Breast cancer metastazing to the uterine cervix. Cancer 1988; 61: (12): 558-60

2. Suplementi i revistës

Wayet JI, Rathbone BJ.	Autori (autorët)
Immune response of the gastric mucosa to Compylbacteri pylori.	titulli
Scan J Gastroenterol	emri i revistës
1988;	viti
23 (suppl.142):	numri
44-9.	faqet

2. Wayet JI, Rathbone BJ. Immune response of the gastric mucosa to Compylbacteri pylori. Scan J Gastroenterol 1988; 23 (suppl.142): 44-9.

3.Libri (monografia)

Mark EJ.	autori
Lung biopsy interpretation.	titulli i veprës
Baltimore:	vendi i botimit
Williams&Wilkins,	botuesi
1984:	viti i botimit
31-2, 94-102.	faqet

3. Mark EJ. Lung biopsy interpretation. Baltimore: Williams&Wilkins, 1984: 31-2, 94-102.

4. Kapitulli i librit

Schielber GL.	autori
Diseases of tricuspid valve.	titulli i punimit
In (në): Moss AJ, Adams F, eds.(red.)	
Heart diseases in infants, children and adolescents.	titulli i librit
Baltimore:	vendi i botimit
Williams&Wilkins,	botuesi
1968:	viti i botimit
134-9.	faqet

4. Schielber GL. Diseases of tricuspid valve. In (në): Moss AJ, Adams F, eds.(red.) Heart diseases in infants, children and adolescents. Baltimore: Williams&Wilkins, 1968: 134-9.

5.Përmbledhja e punimeve

Disha M.	autori
Veprimet anësore dhe toksike të barnave.	titulli i punimit
Përmbledhje të referatve dhe të rezymeve të takimit	
IV profesional të Mjekëve të Kosovës.	titulli i përmbledhjes
Prishtinë:	vendi
1986;	viti
29-32.	faqet

5. Disha M. Veprimet anësore dhe toksike të barnave. Përmbledhje të referatve dhe të rezymeve të takimit IV profesional të Mjekëve të Kosovës. Prishtinë: 1986; 29-32.

6.Grupi i autorëve (autori kolektiv)

Multicenter Postinfarction Research Group	institucioni-grupi i autorëve
Risk stratification and survival after myocardial infarction.	titulli
N Engl J Med	emri i revistës(botuesit)
1983;	viti i botimit
309:	numri
331-6.	faqet

6. Multicenter Postinfarction Research Group. Risk stratification and survival after myocardial infarction. N Engl J Med 1983; 309: 331-6.

7. Artikulli anonim

Artikull anonim	
Coffe drinking and Cancer of pancreas.	titulli
Br Med J	revista
1981;	viti i botimit
283;	vëllimi
626.	faqja

7. Coffe drinking and Cancer of pancreas. Br Med J 1981; 283: 626.

8. Gazeta

Latifi H.	autori
Tuberkulozi në Kosovë në periudhënjatar tetor.	titulli
Bujku	emri i gazetës
1994 (20 dhjetor);	viti, data, muaji
1041:	numri
6.	faqja

8. Latifi H. Tuberkulozi në Kosovë në periudhënjatar tetor. Bujku 1994 (20 dhjetor); 1041: 6.

9. Disertacioni i doktoratës (teza e magjistraturës)

Cairns RB.	autori
Infrared spectroscopic studies of solid oxygen.	titulli
(disertacion)	
Berleley, California:	vendi
University of California,	Universiteti (fakulteti)
1965,	viti
faqe 156.	faqja

9. Cairns RB. Infrared spectroscopic studies of solid oxygen. (disertacion) Berleley, California: University of California, 1965, faqe 156.

Raporte, burime nga Interneti, etj.

10. National Library of Medicine. Medical informatics. Bethesda, MD: National Institutes of Health; 1986 Dec; p. 16–25. (National Library of Medicine Long Range Plan, Report of Panel 4.)

11. Medical Library Association. MLANET [Internet]. Chicago, IL: The Association; 1996 ërev. 1 Jan 2008; cited 24 Jan 2008]. <<http://www.mlanet.org>>.

12. Joint Commission. "What did the doctor say?": improving health literacy to protect patient safety [Internet]. The Commission; 7 Feb 2007 [cited 8 Feb 2007]. http://www.jointcommission.org/NR/rdonlyres/D5248B2E-E7E6-4121-8874-99C7B4888301/0/improving_health_literacy.pdf>.

13. Virginia Commonwealth University Health System. About us [Internet]. The System [11 Apr 2007]. <<http://www.vcuhealth.org/?id=5&sid=1>>.

14. Dickerson S, Reinhart AM, Feeley TH, Bidani R, Rich E, Garg VK, Hershey CO. Patient Internet use for health information at three urban primary care clinics. J Am Med Inform Assoc. 2004 Nov–Dec;11(6):499–504. DOI: 10.1197/jamia.M1460.

ILUSTRIMET

Çdo ilustrim duhet të ketë titullin, pjesën tekstuale, shënimet ose shpjegimet, të gjitha në gjuhën angleze. Shpjegimet (legjenda) shënohen në ilustrim. Parapëlqehet madhësia e ilustrimeve (tabelave, grafikoneve, fotografive, skicave) deri 6x8 cm. Marrja dhe riprodhimi i ilustrimeve nga autorë të tjerë, duhet të bëhet me lejen e botuesit dhe të autorit. Në tekstin e punimit autori vendosë ilustrimet përkatëse. Ilustrimet duhet kufizuar në numër të arsyeshëm, meqë këto e shtrenjtojnë botimin. Titulli, i shkruar në krye të ilustrimit, duhet të jetë konciz dhe përmbajtësor, ashtu që lexuesi ta ketë të qartë për çka është fjala.

Tabelat dhe grafikonët duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme lehtë, jo të komplikuar dhe të stërngarkuara me të dhëna. Shkurtesat e përdorura (shifrat romake, shkronjat e mëdha, ose shenjat e tjera) shpjegohen nën ilustrim, të renditura si fusnota. Sigurohu që çdo tableë është cituar në tekst. Tabelat dhe grafikonat autori i vendosë në vendin përkatës të tekstit të punimit, si një fajll (në formatin Word). Përveç vendosjes së tableve, grafikonët dhe ilustrimeve në tekstin e punimit, grafikonët dhe ilustrimet tjera duhet të dorëzohen edhe si fajlla të vaçantë, në formatin e tyre origjinal.

Nëse përdorni të dhëna nga burime të tjera të publikuara ose të papublikuara, siguroni pëlqimin për përdorimin e tyre, me falenderimin pasues.

Instruksionet për krijimin e tabelave dhe të diagrameve

- Tabelat punohen në editorin e tabelave të programit Word, ose transferohen në atë format–editor.
- Nuk pranohen tabelat në formatin e fotografive.
- Tabelat duhet të kenë numrin rendor dhe titullin e tabelës (P.sh: Tabela 1. Distribuimi i rasteve).
- Tabelat duhet të kenë rrallonin një (1).
- Tabelat nuk pranohen nëse janë krijuar duke përdorë hapësirë ose funksionin Tab.
- Të dhënat shënohen (organizohen) në rreshta dhe kolona; Të gjitha kolonat duhet të kenë një titull të shkurtër ose një shkurtesë të titullit.
- Numri dhe përqindja shënohen në të njëjtën qelizë, sikurse edhe masat e variabilitetit, si dhe të dhënat korresponduese statistikore. Në kolonën e parë të tabelës përshkruhet karakteristika dhe tregohet njësia matëse ose me çka shprehet.
- Fusnotat në tabela mund të përdoren për të dhënë sqarime shtesë lidhur me metodat statistikore të shfrytëzuara, ose rezultatet e testeve me sinjifikancën statistikore të fituar.
- Të dhënat të cilat vlejné për më shumë se një resht, qelizat nuk lejohet të bashkohen vërtikalisht, por vlera shënohet përafërsisht në qelizën që është më së afërmi mesit të reshtit (p.sh. shih Tabelën 2, p-vlera 0.05 është shënuar, përafërsisht, në qelizën që është më së afërmi mesit të reshtave).
- Tabelat kontrohen ashtu që krahasimi ndërmjet grupeve bëhet në mënyrë horizontale (shih Tab. 1)
- Nuk theksohen të gjitha vijat e ndërmjetme horizontale dhe vërtikale të cilat ndajnë çdo qelizë të tabelës veç e veç. Vijat janë vetëm horizontale dhe kufizojné vetëm kryereshtin dhe totalin.

Tabela 1. Titulli

Karakteristika	Grupi A (n=xx)	Grupi B (n=xx)
Mosha mesatare (devijimi standard), vjet	42.5 (8.2)	37.8 (7.2)
Femra, Nr.(%)	30 (45)	20 (40)

Burimi: te dhena fiktive, per qellime ilustrimi

Tabela 2. Titulli

Grup-mosha, vjet	Vlera	P-vlera
10-14	150	
15-19	125	0.05
20-24	130	

- Grafikonet punohen në programin Excel, ose me ndonjë software standard për përfitimin e grafikonëve.
- Grafikoni numërohet me numra arab, te percjellur me pike, pas se cilës shënohet titulli i grafikosit.
- Dukuritë dihotome nuk prezantohen në grafikosit.
- Grafikonet 3 dimensionale nuk pranohen.
- Grafikoni duhet punuar ashtu qe te sigurohet pamje e mire dhe dallim i karakteristikave në botim.
- Grafikonët mund të punohen në ngjyrë zi-e bardhë ose në kolor.

Figurat. Të kompresohen para se të dërgohen në formë elektronike (formati: .rar ose zip). Formatet që pranohen janë BMP, DOC, EPS, JPEG, GIF, TIFF.

Integriteti i imazheve: (klinike, radiografi, mikrografi, gels, etj) mund të bëhet përshtatja digjitale për ndriçim, kontrast ose ngjyrë po qe se kjo është bërë për tërë imazhin dhe nuk paraqet në mënyrë selektuese të dhëna të cilat mund të mashtrjnë, fshehin apo të eliminojnë elemente te figurës origjinale. Nuk lejohet lëvizja e fushës së imazhit, fshirja apo përfshirja e imazhit nga ndonjë fotografi tjetër. Nëse vërehen parregullsi në imazhe, do të kërkohet origjinali i imazhit nga autori.

Video. Formatit: .mov, .wmv, .mpg, .mpeg, .mp4, or .avi, Maksimum 10 MB, Minimum dimensione 320 pixels gjerë dhe 240 pixels thellë, Maksimum kohëzgjatje 5 minuta. Verifikoni se videot mund të shihen në QuickTime ose Windows Media Player.

Audio. Formatit mp3 file, deri 10 MB.

Të gjitha ilustrimet e publikuara më parë mund të merren dhe të riprodhohen pas marrjes së lejes nga botuesi dhe autori, për çka falenderohen.

Njësitë matëse. Vlerat laboratorike shprehen me njësitë matëse të zakonshme, dhe faktorët e konvertimit sipas International System of Units (SI) shprehen në kllapa vetëm herën e parë në tekst. Nëse ka më shumë faktorë konvertimi, ato mund të shënohen së bashku në paragrafin në

fund të seksionit të Metodave. Në tabela dhe figura, faktori i konvertimit në SI duhet shënuar në fusnotë ose legjendë. Preferohet sistemi metrik për gjatësi, sipërfaqe, masë dhe vëllim.

Emrat e barnave, mjeteve dhe produkteve tjera. Nëse emri specifik i tregut nuk është i rëndësishëm esenciale për diskutim, atëherë shfrytëzohen emrat gjenerik të barërave, aparateve dhe produkteve tjera.

Shkurtesat. Preferohet të përdoren sa më rrallë në tekst. **Shkurtesat** nuk përdoren në titull ose abstrakt. Kur përdoren herën e parë, në fillim shkruhet emërtimi i plotë dhe në kllapa shkruhet shkurtesa.

NJOFTIM. Punimet nuk paguhen. Autorit mund t' i jepen falas disa separate të punimit të botuar.